



BASHKIA
TIRANË

1820

51/1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN
KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT**

Nr. Q-10523 prot.
2

Tiranë, më 31/05 / 2021

Lënda: Kthim përgjigje

✓
QENDRËS "RES PUBLICA"

Bulevardi "Gjergj Fishta", godina 24, hyrja 3, ap. 7, Tiranë

I nderuar z. Matlija,

Pranë Bashkisë së Tiranës, bazuar në ligjin 119/2014 "Për të drejtën e Informimit" është paraqitur kërkesa juaj, e cila është protokolluar me nr. prot. Q-10523, datë 17.05.2021 dhe ka kaluar për shqyrtim në Drejtorinë e Përgjithshme të Punëve Publike, e cila nëpërmjet Drejtorisë së Planifikimit të Punëve Publike, ka kthyer përgjigjen me shkresën me nr. prot. Q-10523/1, datë 31.05.2021 si më poshtë:

"Në përgjigje të shkresës suaj, ku parashtroni kërkesën për informacion lidhur me institucionet arsimore të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019, ju informojmë se:

1. Numri i institucioneve arsimore të dëmtuara nga tërmeti i datë 26.11.2019 është 36.
2. Numri i institucioneve arsimore që i janë nënshtruar rikonstruksionit është 11, ndërsa për sa i përket objekteve, për të cilat është vendosur shembja dhe rindërtimi i tyre është 25.
3. Fondi i akorduar për rindërtimin gjendet në VKM me nr. 212, datë 11.03.2020 "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të objekteve arsimore".
4. Listën e institucioneve arsimore të dëmtuara nga tërmeti e gjeni bashkëlidhur kësaj shkrese".

Sa më sipër lutemi në dijeninë tuaj.

Me respekt,

KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT


Blerita Goxha

Objektet arsimore të dëmtuara nga tërmeti "Rikonstruksion"

NR.	Emërtimi
1	Shkolla 9-vjeçare "Emin Duraku"
2	Shkolla 9-vjeçare "Musine Kokalari"
3	Shkolla 9-vjeçare "26 Nëntori"
4	Shkolla e mesme e përgjithshme "Asim Vokshi"
5	Shkolla 9-vjeçare " Myslym Keta"
6	Kopshti Nr. 41
7	Rikonstruksioni i godinës nr. 20-21, nr. 22-23 në RSU nr. 1
8	Rikonstruksioni i godinës TIP nr. 15, në RSU nr. 1
9	Rikonstruksioni i godinës TIP nr. 18, në RSU nr. 1
10	Rikonstruksioni i godinës TIP nr. 19, në RSU nr. 1
11	Rikonstruksioni i 9-vjeçare "Pezë Helmës"

Objektet arsimore të dëmtuara nga tërmeti "Shembje dhe ndërtime të reja"

NR.	Emërtimi
1	Shkolla 9-vjeçare "Hasan Vogli"
2	Shkolla 9-vjeçare "Mangull"
3	Shkolla 9-vjeçare "Pezë e Vogël"
4	Shkolla e mesme e përgjithshme "Sami Frashëri"
5	Shkolla 9-vjeçare " Pajan"
6	Kopshti "Fikas"
7	Kopshti "Gurrë"
8	Shkolla 9-vjeçare "Qazim Turdiu"
9	Shkolla 9-vjeçare "Murat Toptani"
10	Shkolla 9-vjeçare "17Shkurti",Qesarakë e Vjetër
11	Shkolla 9-vjeçare "Lasgush Poradeci"
12	Shkolla 9-vjeçare "Xhezmi Delli"
13	Kopshti nr. 42
14	Ndërtimi i godinës TIP në RSU nr. 2 (Nr. 3)
15	Ndërtimi i godinës TIP në RSU nr. 2 (Nr. 4)
16	Ndërtimi i godinës TIP në RSU nr. 3 (Nr. 1)
17	Ndërtimi i godinës TIP në RSU nr. 3 (Nr. 2)
18	Ndërtimi i godinës TIP në RSU nr. 3 (Nr. 3)
19	Ndërtimi i godinës TIP në RSU nr. 3 (Nr. 4)
20	Ndërtimi i godinës TIP në RSU nr. 3 (Nr. 5)
21	Ndërtimi i godinës TIP në RSU nr. 3 (Nr. 6)
22	Ndërtimi i godinës TIP në RSU nr. 3 (Nr. 7)
23	Ndërtimi i godinës TIP në RSU nr. 3 (Nr. 8)
24	Ndërtimi i godinës Qendra Sociale" Të qëndrojnë së bashku", K. e. e. e.
25	Ndërtimi i godinës "Godina Nr. 22", Bly "Zogu I" (7-katëshi)

VENDIM
Nr.212, datë 11.3.2020

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN
E RINDËRTIMIT TË OBJEKTEVE ARSIMORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, pika 3, shkronja "b", nënndarja "i", 16 dhe 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të objekteve arsimore (projektimin, zbatimin e punimeve, mbikëqyrjen dhe kolaudimin e këtyre objekteve) në vlerën, gjithsej, 7 978 134 932 (shtatë miliard e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë milionë e njëqind e tridhjetë e katër mijë e nëntëqind e tridhjetë e dy) lekë, përkatësisht:

a) Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në vlerën, gjithsej, 4 347 753 223 (katër miliard e treqind e dyzet e shtatë milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e tre mijë e dyqind e njëzet e tre) lekë.

b) Bashkisë Tiranë, në vlerën, gjithsej, 3 630 381 708 (tre miliard e gjashtëqind e tridhjetë milionë e treqind e tetëdhjetë e një mijë e shtatëqind e tetë) lekë.

2. Përdorimi i fondit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, do të jetë 1 994 533 733 (një miliard e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër milionë e pesëqind e tridhjetë e tre mijë e shtatëqind e tridhjetë e tre) lekë, nga të cilat:

a) Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2020, në zërin "Shpenzime kapitale me financim të brendshëm" të programit 06210 "Programe zhvillimi", i shtohet fondi prej 1 086 938 306 (një miliard e tetëdhjetë e gjashtë milionë e nëntëqind e tridhjetë e tetë mijë e treqind e gjashtë) lekësh.

b) Bashkisë Tiranë i transferohet fondi prej 907 595 428 (nëntëqind e shtatë milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e katërqind e njëzet e tetë) lekësh, në formën e transfertës së pakushtëzuar.

4. Fondet e mbetura të papërdorura, pas përfundimit të procedurave të prokurimit, në zbatim të këtij vendimi, kthehen në zërin "Fondi për rindërtim", të buxhetit të shtetit.

5. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama